

**NJOFTIM
PËR MBLEDHJEN E ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME
TË AKSIONERËVE TË "BANKA CREDINS" SH.A.**

Për: Z/Znj. _____ (Aksioner/Perfaqesues/e i/eAksionerit _____)

Ju njoftojmë se ditën e Marte datë 12 Mars 2019 ora 12:00 në ambientet e " BANKA CREDINS" SH.A., në adresën Rr. "Vaso Pasha" Nr. 8, Tiranë, do të zhvillohet mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionerëve të "BANKA CREDINS" SH.A me rend dite si më poshtë:

1. Mbi miratimin e ndryshimeve ne Statutin e Banka Credins sh.a.
2. Mbi miratimin e Buxhetit te shoqërisë "Banka Credins" Sh.a per vitin 2019 përgatitur sipas IFRS dhe Metodologjisë se Raportimit te Bankës se Shqipërisë.
3. Mbi miratimin e Plan Biznesit te Bankes Credins sh.a per vitin 2019.
4. Mbi dhënien e miratimit lidhur me përfaqësimin e Bankës Credins nga z.Maltin Korkuti ne mbledhjen e Asamblesë se Përgjithshme te Jashtëzakonshme te Aksionareve te Shoqërisë Credins Invest sh.a. Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive me rend dite si me poshtë:
 - 1) Mbi miratimin e raportit të auditit të pavarur, pasqyrave financiare vjetore të audituara të Shoqërisë Administruese Credins Invest sh.a., pasqyrave financiare të audituara të Fondit të Pensionit "Credins Pension", si dhe pasqyrave financiare të audituara të Fondit të Investimit "Credins Premium" për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2018.
 - 2) Mbi miratimin e shpërndarjes se rezultatit të Shoqërisë Credins Invest sh.a. për vitin e mbyllur më 31.12.2018.
 - 3) Çështje të tjera parashikuara shprehimisht nga ligji.
5. Ngarkohet Drejtoria te ndjeke procedurat e nevojshme prane Bankes se Shqiperise dhe te beje njoftimet / regjistrimet perkatese ne perputhje me Ligjin.

Jeni të lutur të paraqiteni. Ju Faleminderit.

Maltin KORKUTI

DREJTOR I PËRGJITHSHËM



Tirane me 19.02.2019

Sqarojmë se:

Referuar Statutit të shoqërisë dhe Ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008, «Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare» Aksionerët kanë këto të drejta dhe detyrime:

- Aksionarët, të cilët zotërojnë aksione, që përfaqësojnë të paktën 5 për qind të kapitalit të regjistruar të shoqërisë ose një përqindje më të vogël, të parashikuar në statut, mund t'u drejtojnë administratorëve një kërkesë me shkrim, përfshirë komunikimin me postë elektronike, për të thirrur asamblenë e përgjithshme dhe/ose, jo më vonë se 8 ditë përpara datës së mbledhjes së asamblesë, të kërkojnë përfshirjen e çështjeve të caktuara në rend të ditës. Në kërkesë duhet të jepen arsyet dhe objektivat, si edhe çështjet për të cilat duhet të marrë vendime asambleja e përgjithshme. Nëse kërkesa nuk është pranuar, këta ortakë kanë të drejtë të thërrasin asamblenë e përgjithshme e të vendosin çështje në rendin e ditës, në përputhje me pikën 1 të nenit 137 të ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008, «Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare»

- Nëse asambleja e përgjithshme, në kundërshtim me sa më sipër, nuk thirret, ose çështja e kërkuar prej këtyre nuk përfshihet në rendin e ditës, secili prej aksionarëve, që kanë bërë kërkesën, ka të drejtë:

a) të ngrejë padi në gjykatë për të deklaruar shkeljen e detyrimit të besnikërisë, nëse organet drejtuese nuk përmbushin kërkesat e tyre brenda 15 ditëve;

b) t'i kërkojnë shoqërisë blerjen e aksioneve të zotëruara prej tyre, sipas nenit 133 të ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008, «Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare».

- Në rastet kur rendi i ditës ndryshohet, dhe thirrja u është njoftuar ortakëve, administratorët njoftojnë përsëri rendin e ditës, në të njëjtat mënyra, me të cilat është kryer njoftimi i parë.

- Një aksionar mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një prokure nga një aksionar tjetër, apo nga një person i tretë.

- Administratorët dhe anëtarët e këshillit mbikëqyrës nuk mund të veprojnë si përfaqësues të aksionarëve në asamblenë e përgjithshme.

- Prokura, mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

- Përfaqësuesi i autorizuar është i detyruar të deklarojë çdo fakt apo rrethanë, të tillë që, sipas gjykimit të aksionarit të përfaqësuar, rrezikon të ndikojë në vendimmarrjen e përfaqësuesit për interesa të tjerë të ndryshëm nga ata të aksionarit përfaqësuar.

- Asambleja merr vendimet nëpërmjet votimit të hapur.

- Për emërimin dhe shkarkimin e anëtarëve të këshillit mbikëqyrës apo administratorëve, asambleja e përgjithshme vendos me votim të fshehtë, nëse kjo mënyrë votimi kërkohet nga aksionarët, të cilët zotërojnë një numër aksionesh, që përfaqësojnë të paktën 5 për qind të kapitalit të regjistruar të shoqërisë.

- Kopje të dokumentave dhe projekt-vendimeve bashkëlidhur me këtë njoftim do të gjeni edhe pranë Selisë së shoqërisë, nëpërmjet një kërkesë me shkrim të depozituar pranë shoqërisë "Credins Bank" sh.a.